



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
MINISTRIA E MBROJTJES**

**UDHËZIM PËR ZBATIMIN E RREGULLORES  
PËR PLANIFIKIM, PROGRAMIM,  
BUXHETIM DHE REALIZIM  
NË MINISTRINË E MBROJTJES**

*Shkup,  
shkurt 2019*

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJA DHE DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</b> .....		
..... 4		
- Hyrja .....		4
- Dispozitat e përgjithshme .....		6
- Lënda e udhëzuesit.....	6	
- Në përgjithësi për RPPBR.....		6
-Kompetencat, përgjegjësitë dhe dokumentet.....	7	
<b>2. PLANIFIKIMI</b> .....		8
- Planifikimi strategjik .....		8
- Planifikimi afatgjatë .....	9	
- Planifikimi afatmesëm .....		10
- Planifikimi afatshkurtër .....		12
<b>3. RPPBR dhe sistemi i akuizicionit</b> .....	12	
- Integrimi dhe sinkronizimi.....		12
- Përkufizimi i nevojave materiale.....	13	
<b>4. PROGRAMIMI</b> .....		15
- Elementet dhe menaxhimi i programeve.....	16	
- Elementet e programit .....		18
- Përpunimi dhe vërtetimi i programeve.....	20	
- Takimet e planifikuara për programet.....	21	
<b>5. BUXHETIMI</b> .....		24
- Sigurimi i mjeteve financiare.....	24	
- Propozimbuxheti .....		24
- Përgatitja e propozimbuxhetit.....		25
- Qarkullimi buxhetor .....		25
- Udhëzime për përpunimin e propozimbuxhetit.....		26
- Roli dhe përgjegjësia e SHSH së ARM-së.....	27	
- Dokumente të lëshuara nga pjesëmarrës të tjerë në RPPBR....		28
- Mënyra e shprehjes së nevojave.....	28	
- Shqyrtimi dhe miratimi i propozimbuxhetit.....	29	
<b>6. REALIZIMI</b> .....		31
- Plani financiar .....		31
- Rishikimi dhe shpërndarja (ridestinimi).....	32	
- Plani i prokurimeve.....		32
- Pasqyra e aftësive mbrojtëse.....	35	
<b>7. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA</b> .....		
37		
<b>8. SHTOJCA DHE FORMULARË</b> .....		
38		

Në pajtim me nenin 55, paragrafi 1 të Ligjit të Organizimit dhe të Punës së Organeve të Administratës Shtetërore (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) e në lidhje me nenin 142 të Ligjit të Mbrojtjes (Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 42/01, 5/03, 58/06, 110/08, 51/11, 151/11 dhe 215/15) dhe nenet 69 dhe 70 të Rregullores për planifikim, programim, buxhetim dhe realizimin në Ministrinë e Mbrojtjes, ministrja e mbrojtjes miraton

### UDHËZIM PËR ZBATIMIN E RREGULLORES PËR PLANIFIKIM, PROGRAMIM, BUXHETIM DHE REALIZIM NË MINISTRINË E MBROJTJES

# 1. HYRJA DHE DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

## HYRJA


1.1. Sistemi i planifikimit, programimit, buxhetimit dhe realizimit (në tekstin e mëtejshëm: PPBR), që u prezantua në Ministrinë e Mbrojtjes (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) për të siguruar menaxhimin e burimeve dhe zhvillimin sistematik, racional dhe të planifikuar të mbrojtjes, parashikohet në nenin 142 të Ligjit të Mbrojtjes, ndërsa më hollësisht i përpunuar në Rregulloren për planifikim, programim, buxhetim dhe realizim në Ministrinë e Mbrojtjes (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja).

1.2. Sistemi PPBR zbatohet në Ministrinë e Mbrojtjes për alokimin e burimeve për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve që janë përcaktuar si të nevojshme për realizimin e misioneve të mbrojtjes. Qëllimi përfundimtar është të sigurohet proces sistematik dhe i disiplinuar për t'i siguruar Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Armata) kombinim optimal dhe racional të forcave, pajisjeve dhe mbështetjes që është i arritshëm brenda kufizimeve të përcaktuara fiskale.

1.3. Sistemi PPBR ofron kornizë dhe siguron mekanizma për vendimmarrje racionale për të ardhmen si dhe ofron mundësi për t'i rishikuar vendimet e viteve të mëparshme duke marrë parasysh rrethanat aktuale (përkatësisht kërcënimet e reja, kushtet e ndryshuara ekonomike, etj.) Sistemi PPBR i mbulon fushat funksionale që janë të nevojshme për zhvillimin dhe mbështetjen e forcave të armatosura:

- personelin;
- organizimin;
- edukimin dhe trajnimin;
- materialet;
- objektet;
- mirëmbajtjen.

1.4. Sistemi PPBR është proces i vazhdueshëm dhe i përsëritshëm, i përbërë nga disa faza të ndërlidhura: planifikimi, programimi, buxhetimi dhe realizimi:



VB = Viti buxhetor

VA = Viti aktual

Skema nr. 1

- Planifikimi është faza e parë, në të cilën, në bazë të dokumenteve strategjike, përcaktohen synimet dhe prioritetet zhvillimore afatgjata dhe afatmesme të Ministrisë dhe planifikohen aftësitë dhe kapacitetet mbrojtëse, të shprehura nëpërmjet madhësisë, strukturës dhe burimeve të nevojshme.

- Programimi mundëson shndërrimin e planeve në programe specifike dhe integrimin e nevojave dhe kërkesave në pajtim me politikat dhe prioritetet e Ministrisë.
- Në fazën e buxhetimit sigurohen burime financiare për programet e miratuara.
- Realizimi përfshin zbatimin e burimeve financiare të miratuara në pajtim me planet dhe programet për ndërtimin e kapaciteteve dhe aftësi si dhe për sigurimin e menaxhimit të cilësisë dhe monitorimin e shpenzimeve të miratuara për zbatimin e programeve të pranuar.

## **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

### **Lënda e udhëzuesit**

1.5. Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores për planifikim, programimin, buxhetim dhe realizim në Ministrinë e Mbrojtjes (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzuesi) i shtjellon hollësisht dispozitat e Rregullores dhe mundëson zbatimin e saj në praktikë.

1.6. Udhëzuesi konkretizon kompetencat, rolin dhe obligimet e të gjithë pjesëmarrësve në sistemin PPBR, realizimin e të gjitha fazave në sistem (planifikim, programim, buxhetim dhe realizim) dhe afatet në të cilat zhvillohen të njëjtat sipas kalendarit të aktiviteteve.

Udhëzuesi shpjegon dokumentet, përmbajtjen dhe formën e tyre, procedurat dhe afatet në të gjitha fazat e sistemit PPBR.

### **Në përgjithësi për PPBR**

1.7. Sistemi PPBR në Ministrinë e Mbrojtjes është sistemi parësor për menaxhimin e burimeve dhe zhvillimin sistematik, racional dhe të planifikuar të mbrojtjes

1.9. Sistemi PPBR i mundëson Ministrisë dhe Armatës të zhvillojnë plane plotësisht të integruara, të zhvillojnë programe dhe të përgatisin dhe realizojnë buxhete në të gjitha nivelet përkatësisht lidh sistematikisht dokumentet strategjike me planet dhe programet kurse programet me buxhetin.

1.10. Sistemi PPBR ofron metodologji dhe proces për menaxhimin efikas të burimeve në Ministri që mundëson:

1. Zhvillim të planeve shumëvjeçare dhe identifikim dhe vërtetim të nevojave bazuar në misionet dhe aftësitë dhe kapacitetet e kërkuara;
2. Zhvillim të nevojave dhe kërkesave të vërtetuara në programet shumëvjeçare;
3. Përgatitje të buxhetit në bazë të programeve të miratuara;
4. Realizimi dhe kontrolli i buxhetit të miratuar.

1.11. Nëpërmjet sistemit PPBR, Ministria dhe Armata argumentojnë nevojat për aftësi dhe kapacitete të nevojshme për të përmbushur misionet e përcaktuara nga dokumentet strategjike dhe të përpunuara sipas fushave funksionale (personel, organizim, arsimim dhe trajnim, material, objekte dhe mirëmbajtja) dhe brenda burimet financiare në dispozicion.

Kjo është e mundshme sepse Sistemi i PPBR:

- Përdor parime të vërtetuara ekonomike;
- Bazohet në fakte, është i qartë dhe lejon analiza;
- Është transparent dhe respekton parimet dhe standardet demokratike në menaxhimin e burimeve;
- Rrit përgjegjësinë në posedimin e burimeve;
- Është konceptualisht i qartë, fokusohet në programet dhe synimet që duhet të arrihen nëpërmjet tyre;
- Bazohet në argumente në kërkesën e burimeve dhe mbështet shpërndarjen optimale të tyre;
- Mundëson vendimmarrje në kohë, të mbështetur nga zgjidhje dhe analiza alternative;
- Maksimizon aftësitë në të gjitha nivelet;
- I mundëson Ministrisë së Mbrojtjes të planifikojë strukturën e forcave, aftësive dhe kapaciteteve, interoperative me vendet-anëtare të NATO-s.

1.8. Vendimet që merren duke zbatuar Sistemin PPBR bazohen në informacione të besueshme për zgjidhjet e mundshme alternative, që çon në marrjen e vendimeve më racionale dhe ekonomike në realizimin e misionëve të mbrojtjes.

### **Kompetencat, përgjegjësitë dhe dokumentet**

1.12. Kompetenca dhe përgjegjësia për funksionimin e Sistemit PPBR përshkruhet në nenet 7 deri në 16 të Rregullores dhe në thelb ndjek parimin e pandashmërisë së planifikimit nga udhëheqja dhe komandimi.

Numri i madh i pjesëmarrësve në këtë proces mundëson transparencë maksimale, përpunimin e propozimeve alternative dhe vendimmarrje bazuar në argumente.

Përfshirja e pjesëmarrësve përkatës në të gjitha nivelet, sipas kompetencave, në procesin e hartimit të planeve, programeve dhe buxheteve, siguron besueshmëri në realizim dhe një formë të standardizuar të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

1.13. Procedura e përcaktuar për përgatitjen e dokumenteve në Ministri dhe Armatë dhe punësimi i personelit drejtues në Grupin e programit dhe menaxhimit siguron siguri në marrjen e vendimeve, gjë që do t'i mundësojë Ministrisë dhe Armatës efikasitet maksimal në menaxhimin e burimeve në dispozicion.

1.14. Parimi i pandashmërisë së Sistemit PPBR nga sistemi i menaxhimit dhe komandës, në të gjitha fazat, mundëson personat përgjegjës dhe të autorizuar (ministri, zëvendësministri, sekretari shtetëror, këshilltarët shtetëror, udhëheqësit e sektorëve, shefi i Shtatmadhorisë së Armatës së Republika e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: shefi i Shtatmadhorisë), zëvendës-shefi i Shtatmadhorisë, drejtori i Shtatmadhorisë, shefat e seksioneve dhe komandantët) të miratojnë akte që, nëse është e nevojshme, do të japin udhëzime dhe urdhra shtesë në procesin e hartimit të dokumenteve dhe realizimin e buxhetit.

1.15. Dokumentet themelore janë të përshkruara në nenin 17 të Rregullores dhe e mbështesin Sistemin PPBR në të gjitha fazat, nga planifikimi deri në realizim.

Udhëzuesi parashikon përmbajtjen dhe formën e obligueshme të dokumenteve dhe formularëve, që siguron unifikimin dhe qasje të standardizuar në procedura si dhe përpunimin e të dhënave.

## 2. PLANIFIKIMI

2.1. Planifikimi i mbrojtjes në Ministri dhe Armatë bazohet në dokumente strategjike dhe është faza e parë në sistemin PPBR.

Është fazë në të cilën përcaktohen qëllimet dhe prioritetet afatgjata dhe afatmesme dhe përcaktohen aftësitë dhe kapacitetet mbrojtëse të shprehura nëpërmjet madhësisë, strukturës dhe burimeve të nevojshme në pajtim me nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.2. Rezultati i kësaj faze është përgatitja e planit të zhvillimit afatgjatë për periudhë dhjetëvjeçare dhe plani zhvillimor afatmesëm për periudhë katërvjeçare. Realizimi është planifikuar nëpërmjet planeve afatshkurtra njëvjeçare, të cilat do të sigurohen me mjete financiare nëpërmjet buxheteve njëvjeçare.

### Planifikimi afatgjatë

2.2. Planifikimi afatgjatë i mbrojtjes bëhet në bazë të dokumenteve të përcaktuara në nenin 4 të Rregullores, të miratuar nga Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.3. Koncepti i Sigurisë dhe mbrojtjes nacionale, Strategjia e mbrojtjes dhe dokumente të tjera strategjike janë dokumente themelore konceptuale, mbi bazën e të cilave projektohen kapacitetet dhe burimet e mbrojtjes në terma afatgjatë, si përgjigje të mjedisit të sigurisë, sfidave dhe kërcënimeve për sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

2.7 Plani afatgjatë i zhvillimit përditësohet çdo katër vjet, jo më vonë se fundi i qershorit, bazuar në Udhëzimet e nxjerra nga ministri i mbrojtjes.

2.7. Plani afatgjatë i zhvillimit (në tekstin e mëtejme: PAZH) ofron projeksion të aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse të Ministrisë dhe Armatës që nevojiten për t'i përmbushur kërkesat e Konceptit nacional për siguri dhe mbrojtje si dhe të Strategjisë së mbrojtjes, për dhjetë vitet e ardhshme.

- 2.8. Plani zhvillimor afatgjatë parashikon projeksion të aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse për periudhë dhjetëvjeçare, veçanërisht në: Politikën e mbrojtjes – e përgatit Sektori i politikës dhe planifikimit (në tekstin e mëtejme: SPP);
- Struktura e forcave - e përgatit Shtatmadhuria;
- Personeli - e përgatit Sektori burimeve njerëzore (në tekstin e mëtejme: SBNJ) për Ministrinë kurse Shtatmadhuria për Armatën;
- Pajisja dhe modernizimi - e përgatit Sektori i logjistikës (në tekstin e mëtejme: SL) për Ministrinë kurse Shtatmadhuria për Armatën;
- Arsimi dhe trajnimi - e përgatit SBNJ për Ministrinë kurse Shtatmadhuria për Armatën;
- Infrastruktura - e përgatit Sektori i patundshmërive (në tekstin e mëtejme: SP) për Ministrinë kurse Shtatmadhuria për Armatën;
- Burimet financiare - e përgatit Sektori i financave (në tekstin e mëtejme: SF)

2.9. Projeksioni afatgjatë i buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes shprehet në formën e përcaktuar në këtë Udhëzues (formulari **PL-1**)

PËRSHKRIMI	VITI/DENARË									
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
PBV										

Përqindja										
Buxheti										

- PBV (Prodhimi Bruto Vendor) – të dhënat i siguron Ministria e Financave, bazuar në treguesit makroekonomikë,
- Përqindjen e ndarjes për nevojat e mbrojtjes e përcakton Qeveria,
- Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes llogaritet në bazë të parametrave të mëparshëm.

### Planifikimi afatmesëm

2.10. Plani afatmesëm i zhvillimit (në tekstin e mëtejshëm: PAZH) përditësohet çdo dy vjet, jo më vonë se fundi i qershorit, bazuar në Udhëzimet e nxjerra nga ministri i mbrojtjes. Programet e PAZH përgatiten çdo vit në bazë të Udhëzimeve të Programimit, të nxjerra nga ministri.

2.11. Plani afatmesëm i zhvillimit rezulton nga projeksioni afatgjatë i miratuar i dhënë në PAZH (plani afatgjatë i zhvillimit) dhe përfaqëson përpunimin e qëllimeve të planit afatgjatë në nevoja specifike të aftësive dhe kapaciteteve sipas të njëjtave njësi planifikimi për periudhë prej katër vjet.

Ndryshe nga PAZH (plani afatgjatë i zhvillimit) i cili është në fakt vizion për dhjetë vitet e ardhshme, PAZH (plani afatmesëm i zhvillimit) përpunon në mënyrë specifike qëllimet e PAZH (plani afatgjatë i zhvillimit) në nevojat konkrete të aftësive dhe kapaciteteve për periudhën e katër viteve të para, sipas fushave funksionale të mëposhtme:

- Personeli – përcakton madhësinë e forcës;
- Organizimi – përcakton strukturën specifike të forcës;
- Arsimi dhe trajnimi- përcakton edukimin dhe aftësimin kryesor për të mbështetur forcën;
- Materiali – përcakton pajisjet dhe nevojat e tjera materiale për forcat;
- Objektet – përcakton nevojat infrastrukturore për të mbështetur forcën dhe pajisjet;
- Mirëmbajtja – përcakton nevojën për mbështetje adekuate logjistike të forcave.

2.11. Plani afatmesëm i zhvillimit është plan për grupe të veçanta të detyrave, aktiviteteve dhe projekteve, me parametra financiarë të nevojshëm për realizimin e tyre, sipas dinamikës së planifikuar, sipas viteve dhe programeve. Siguron përgatitjen e opsioneve dhe alternativave për realizimin e misioneve specifike, kapaciteteve të identifikuara dhe të kërkuara.

2.12. Zhvillimi i PAZH bazohet në prioritetet e përcaktuara. Mjetet planifikohen sipas rendit të mëposhtëm të rëndësisë:

1. Mirëmbajtja operative e burimeve njerëzore dhe materialeve, në nivelin e përcaktuar në planin afatgjatë të zhvillimit;
2. Mjete për financimin e obligimeve eventuale;
3. Mjetet për projekte të reja, në kuadër të mundësive reale.

2.13. Në PAZH (plani afatmesëm i zhvillimit), shpenzimet përpunohen si kornizë, për të përcaktuar sasinë e burimeve financiare në dispozicion për miratimin e projekteve të reja në katër vitet e ardhshme. PAZH (plani afatmesëm i zhvillimit) është dokument që është bazë për planet vjetore afatshkurtra.

2.14. Të dhënat për shpërndarjen kornizë të burimeve financiare të parashikuara sipas programeve dhe viteve, për vitin buxhetor (viti për të cilin përgatitet propozim-buxheti) dhe për tre vitet e ardhshme, sigurohen nga SF në bashkëpunim me SPP-në. Të dhënat jepen sipas prodhimit bruto vendor të projektuar (PBV) dhe përqindjes së përcaktuar të PBV-së, të dedikuar për financimin e mbrojtjes.

2.15 SF në bashkëpunim me SPP, treguesit financiarë për nevojat e PAZH (plani afatmesëm i zhvillimit) i përgatit si në tabelën më poshtë:

**PLANI AFATMESEM I  
MINISTRISE SE MBROJTJES**

PROGRAMI		VITI/DENARE					
Numri	Emertimi						
1	2	3	4	5	6	7	8
<b>GJITHSEJ</b>							

**Sqarim:**

Kolona nr 1. Numri i programit

Kolona nr 2. Emertimi i programit

Kolona nr. 3-6 Katër vitet të cilave u referohet  
plani afatmesëm i zhvillimit

**Planifikimi afatshkurtër vjetor**

2.16. Planifikimi afatshkurtër vjetor është pjesë përbërëse e planifikimit që realizon menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale dhe lidh drejtpërdrejt planifikimin me programimin dhe përgatitjen e buxhetit. Planet afatshkurtra vjetore rezultojnë nga vendimet e marra në SPR dhe përfshijnë vendimet nga zona specifike funksionale për vitin e ardhshëm. Planet vjetore afatshkurtra paraqesin bazën për përgatitjen e informacioneve të hollësishme mbi strukturën e programit dhe në procesin e identifikimit të shpenzimeve të hollësishme në lidhje me realizimin e programeve.

2.17. Planifikimi afatshkurtër realizohet nëpërmjet planit vjetor të punës dhe planeve sipas fushave funksionale të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

**3. RPPB DHE SISTEMI I AKUIZIONIT**

**Integrimi dhe sinkronizimi**

3.1. Në fazën e planifikimit, gjatë përcaktimit të nevojave dhe gjetjes së zgjidhjeve më efektive, është e obligueshme zbatimi i Udhëzuesit për akuizicion. Udhëzuesi i akuizicionit përshkruan procedurat dhe veprimet në të gjitha fazat e procesit të akuizicionit përkatësisht:

- përcaktimi i nevojave;
- vlerësimi i alternativave;
- realizimi i prokurimeve;
- miratimi dhe përdorimi i pajisjeve.

3.2. Aktivitetet e sistemit PPBR dhe sistemit të akuizicionit duhet të sinkronizohen për të siguruar integrimin e aktiviteteve ndërmjet operacioneve, financave dhe logjistikës. Kjo krijon proces fleksibil të integruar të menaxhimit për interpretimin e nevojave të misionit të mbrojtjes. Kur verifikohet nevoja dhe kur krijohet programi i akuizicionit dhe prokurimit, sistemi i akuizicionit dhe sistemi PPBR sinkronizojnë aktivitetet e tyre për të siguruar fillimin e sigurt të akuizicionit, menaxhimin dhe zbatimin e tij sipas prioriteteve strategjike dhe burimeve. Programet e akuizicionit dhe prokurimit përfshijnë akuizicionin e pajisjeve dhe armëve si dhe prokurimin e materialeve dhe shërbimeve, duke u përpjekur për qasje në kohë dhe çmime më të favorshme.

3.4. Sinkronizimi i sistemit PPBR dhe sistemit të akuizicionit është i rëndësishëm për përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve. Sistemi PPBR prodhon gjithashtu buxhet vjetor kurse sistemi i akuizicionit prodhon plane vjetore dhe afatgjatë për akuizicion dhe prokurim. Të dy sistemet kërkojnë aktivitete të integruara dhe të koordinuara për të arritur qëllimet e identifikuara.

3.5. Me zbatimin e proceseve që përfshihen në sistemin e akuizicionit në mbrojtje, arrihet integrimi i nevojave të misionit, planifikimit financiar, akuizicionit dhe prokurimit brenda Ministrisë dhe Armatës.

### **Përkufizimi i nevojave materiale**

3.6. Sistemi PPBR ofron mjete për planifikim, programim dhe vendimmarrje në mbrojtje, bazuar në kriteret dhe udhëzimet reale të planifikimit të mbrojtjes. Rezultat i kësaj janë planet, programet dhe buxheti që bazohen në proces dinamik dhe analitik që siguron statusin aktual dhe të ardhshëm të aftësive mbrojtëse, kapaciteteve dhe nevojave të Ministrisë dhe Armatës. Procesi i përcaktimit të nevojave vlen për të gjitha fushat funksionale në Ministri dhe Armatë. Ky proces përcakton aktivitetet e nevojshme për të mbështetur pikat 4.27 – 4.29 të këtij Udhëzuesi.

3.7. Përcaktimi i nevojave materiale është proces që përfshin aktivitete që lidhen me:

- përcaktimin e aftësive mbrojtëse, strukturës së forcave dhe kapaciteteve për zbatimin e misioneve të caktuara;
- monitorimin (analizën) e vazhdueshëm të aspektit material dhe jomaterial të aftësive, kapaciteteve mbrojtëse dhe identifikimin e mangësive të caktuara, nëse ka;
- vlerësimin e secilës prej mangësive dhe përcaktimin e prioriteteve për eliminimin e tyre.

3.8. Struktura e forcave dhe kapaciteteve përcaktohen në sistemin, formacionin e personelit dhe atë material. Ato rishikohen rregullisht nëpërmjet procesit të planifikimit (zhvillimit) të mbrojtjes.

3.9. Analiza e nivelit të plotësisë të nevojave materiale (në aspektin cilësor dhe sasior) bëhet në kuadër të analizave të realizimit të planeve vjetore të punës, rishikimit të aftësive mbrojtëse dhe analizës së gatishmërisë luftarake të njësisë organizative (elementet e programit). I njëjti proces vlen edhe për nevoja të tjera të Armatës, si trajnimi, personeli dhe infrastruktura.

3.10. Sektori për politikë dhe planifikim në bashkëpunim me Shtatmadhorinë është përgjegjës për procesin e rishikimit të kapaciteteve të përgjithshme mbrojtëse dhe zbatimin e planeve për zhvillimin e Ministrisë. Ky sektor është gjithashtu përgjegjës për zhvillimin, koordinimin, integrimin dhe përditësimin e planit të zhvillimit afatgjatë dhe afatmesëm.

3.11. Nëse rezultatet e këtij procesi kërkojnë akuizicion afatgjatë të pajisjeve të reja, procesi i planifikimit do të përfshijë procedurat që i përfshin Udhëzuesi për akuizicion. Faza e planifikimit duhet t'i ketë parasysh aktivitetet e ciklit jetësor të materialeve dhe të sigurojë harmonizimin e planeve, akuizicionit/ciklit të prokurimeve dhe buxhetit.

3.12. Në fazën e programimit për nevojat e pajisjeve dhe mjeteve, të përcaktuara në fazën e planifikimit, procesi i akuizicionit vazhdon, që zgjidhjet alternative të miratuara të vendosen në programe dhe të planifikohen burimet e nevojshme financiare për to, në një ose më shumë vite.

Udhëzuesi i akuizicionit është mjet që plotëson sistemin PPBR dhe në fakt është pjesë përbërëse e tij, duke arritur kështu komplementaritetin e sistemit PPBR dhe procesit të akuizicionit.

3.12. Me zbatimin e procesit të akuizicionit, duhet të arrihet ndërveprueshmëria me vendet e tjera anëtare të NATO-s, sa i përket pajisjeve, trajnimit dhe logistikës.

Ky proces bazohet në këto prioritete të përcaktuara:

- prioriteti numër 1. - armatimi, sistemet e armatimit dhe municionet;
- prioriteti numër 2. - mirëmbajtja dhe mbështetja e pajisjeve në Armatë;
- prioriteti numër 3. - objektet dhe infrastruktura.

#### 4. PROGRAMIMI

4.1. Programimi është proces i vazhdueshëm që lidh planifikimin me buxhetimin dhe realizimin. Proces në të cilin qëllimet afatmesme të zhvillimit përpunohen në programe përkatësisht nënprograme, detyra, aktivitete dhe projekte.

4.2. Nëpërmjet programimit përcaktohen dhe analizohen mënyra alternative për arritjen e qëllimeve të caktuara, vlerësohen opsionet e ndryshme sa i përket shpenzimeve dhe dobive (përfitimeve) të mundshme dhe ndikimit të burimeve në dinamikën e planifikuar në arritjen e qëllimeve.

4.3. Programimi është proces nëpërmjet të cilit:

- përcaktohen dhe analizohen zgjidhjet alternative të mundshme për realizimin e planeve;
- identifikohen shpenzimet e planifikuara sipas kategorive dhe viteve të realizimit;
- përshtaten programet sipas burimeve të kufizuara financiare;
- sigurohet baza e analizës në zbatimin e planeve;
- integrohet menaxhimi i burimeve;
- ofrohet baza për vlerësimin dhe përgatitjen e buxhetit të mbrojtjes brenda buxhetit të shtetit.

4.4. Programi përfaqëson disa detyra, aktivitete, projekte dhe nënprograme të ndërlidhura që arrijnë një qëllim të përbashkët. Programi integron burime të ndryshme, të nevojshme për të arritur qëllime të përgjithshme (të përbashkëta) dhe të veçanta. Qëllimi i përgjithshëm e përcakton rezultatit e dëshiruar që duhet të arrihet.

#### Elementet dhe menaxhimi i programeve

4.5. Neni 30 i Rregullores përcakton strukturën programore, e cila mund të ndryshohet nëse është e nevojshme, varësisht nga misionet dhe aktivitetet e Ministrisë dhe Armatës si dhe nga prioritetet e përcaktuara. Përmbajtja e strukturës së përgjithshme programore e shprehur nëpërmjet nënprogrameve, detyrave, aktiviteteve dhe projekteve të miratuara përbën programin e mbrojtjes të Ministrisë.

Në pikat 4.6 - 4.13. ky Udhëzues jep përmbajtjen e programeve të përcaktuara.

4.6. **Programi numër 1: Administrata**, përfshin nënprogramet, detyrat, aktivitetet dhe projektet që sigurojnë funksionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe përmbushjen e obligimeve në fushën e:

- planifikimit dhe përgatitjes së mbrojtjes;
- rregullimin e territorit dhe objekteve;
- bashkëpunimit ndërkombëtar (bashkëpunimit shumëpalësh, dypalësh, rajonal, përfaqësitë ushtarake-diplomatike, kontrollit të armëve, stërvitjet ushtarake ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare);
- mbrojtjes civile;
- sigurisë dhe inteligjencës ushtarake;
- shërbimeve për mbrojtje juridike, financa, logjistikë, revizion dhe kontroll;
- çështjeve administrative- teknike;
- veprimtarisë botuese dhe marrëdhënieve me publikun;

- mbështetjes për komunikim dhe informacion;
- aktivitete të tjera.

**4.7. Programi numër 2: Personeli dhe edukimi** përfshin nënprogramet, detyrat, aktivitetet dhe projektet me të cilat sigurohet:

- menaxhimi i burimeve njerëzore;
- planifikimi i personelit;
- rekrutimi dhe pranimi i personelit për nevojat e Ministrisë dhe Armatës;
- mbajtja dhe motivimi i personelit;
- zhvillimi i karrierës;
- arsimimi dhe trajnimi (kurse, trajnime gjuhësore, trajnime profesionale, arsimim të mëtejshëm, bursa studentore);
- shkollimi në Akademinë ushtarake, specializimet e studimeve post-diplomike;
- përmirësimi i standardit të punonjësve (standardi i jetesës, ndihma sociale, privilegjet dhe përfitimet, kushtet e punës dhe mbrojtja e të drejtave të punonjësve dhe familjeve të tyre, sigurimi i banimit);
- planifikimi i largimit të personelit;
- përgatitje për kthim në jetën civile;
- ndërprerja e punësimit, përgatitjet për pension;
- pension të parakohshëm për shkak të ndryshimeve strukturore;
- organizimi i transportit për në dhe nga puna për punonjësit e Armatës.

**4.8. Programi numër 3: Funkcionimi i ARM-së,** përfshin nënprograme, detyra, aktivitete dhe projekte që sigurojnë funksionimin e Armatës dhe kryerjen e detyrimeve në fushën e:

- punëve administrativo-teknike;
- komunikimeve dhe mbështetjes informatike në Armatë;
- funksionimin operativ të Armatës;
- aktivitete tjera.

**4.9. Programi numër 4: Trajnimi në Armatë,** përfshin nënprograme, detyrat, obligime, aktivitete dhe projekte me të cilat sigurohet lidhja mes trajnimit dhe përgatitjes së Armatës për operacione, në pajtim me misionet e përkufizuara. Nëpërmjet këtij programi sigurohet:

- trajnimi i përbërjes aktive të Armatës;
- trajnimi i përbërjes rezervë të Ushtrisë;
- trajnimi i rekrutëve (shërbim vullnetar në ushtri)
- trajnime për operacione jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- ushtrime ndërkombëtare të Armatës;
- sigurimi i materialeve për trajnim (municioni dhe MEC);
- sigurimi i mjeteve arsimore dhe edukative;
- lloje të tjera të trajnimit.

**4.10. Programi numër 5: Logjistika në Armatë,** përfshin nënprograme, detyra, aktivitete dhe projekte që ofrojnë mbështetje logjistike për Armatën. Programi përfshin këto funksione logjistike:

- punë logjistike operative, MHT dhe MKZ;
- furnizim me materiale të kategorisë 1-4 dhe pjesë të kategorisë 5 dhe shërbime;
- mirëmbajtje të pajisjeve;
- lëvizje dhe transport;
- mbështetje mjekësore;
- aktivitete dhe detyra të tjera logjistike.

**4.11. Programi numër 6: Pajisja dhe modernizimi** përfshin nënprograme, detyra, aktivitete dhe projekte me të cilat planifikohet dhe zbatohet pajisja dhe modernizimi i Ministrisë dhe Armatës. Nëpërmjet këtij programi sigurohet:

- armatimi dhe pajisjet ushtarake për ushtrinë tokësore;
- armatimi dhe pajisjet ushtarake për aviacionin ushtarak;
- formimi dhe mirëmbajtja e VMR me municion dhe MASH;
- pajisje për nevoja logjistike;
- pajisjet e sigurisë dhe inteligjencës;
- pajisje mjekësore;
- mjete luftarake dhe joluftarake;
- municion;
- punë kërkimore shkencore;
- pajisje për Ministrinë e Mbrojtjes;
- lloje të tjera të pajisjeve.

4.12. **Programi numër 7: - Objektet dhe infrastruktura**, përfshin nënprogramet, detyrat, aktivitetet dhe projektet që mundësojnë menaxhimin e planifikuar të patundshmërive, mirëmbajtjen e tyre dhe ndërtimin e objekteve të reja.

Nëpërmjet këtij programi sigurohet:

- ndërtimi i objekteve nëpërmjet klasifikimit të tyre në objekte akomodimi, magazinimi, administrative, termike, të ujësjellësit, të infrastrukturës dhe lloje të tjera të objekteve;
- mirëmbajtja e ndërtimit (të objekteve dhe infrastrukturës);
- banesat zyrtare.

4.13. **Programi numër 8: Operacionet paqësore dhe humanitare**, përfshijnë nënprogramet, detyrat, aktivitetet dhe projektet që kanë të bëjnë me realizimin e operacioneve paqësore dhe humanitare jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4.14. Ministri i Mbrojtjes, në pajtim me nenin 14 të Rregullores, përcakton drejtuesit e programeve, të cilët gjatë përgatitjes dhe zbatimit veprojnë sipas përcaktimeve të Rregullores dhe Udhëzuesit.

### **Elementet programore**

4.16. Qëllimet e dëshiruara në programe arrihen nëpërmjet realizimit në elementet e programit. Elementet e programit janë njësi organizative në Ministri dhe Armatë që marrin pjesë në planifikimin e burimeve dhe zbatimin e programit.

4.17. Personeli si burim i elementit të programit është i paraparë në sistematizimin e personelit për Ministrinë dhe në formacion për Armatën.

4.18. Për elementet e programit në Armatë parashikohet edhe një formacion material, i cili përcakton pajisjet e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të planifikuara.

4.19. Përcaktimi i personelit dhe pajisjeve të nevojshme, në pajtim me aktivitetet e planifikuara, është baza për përcaktimin e burimeve të nevojshme financiare për çdo element të programit, nëpërmjet të cilave përcaktohen edhe nevojat për çdo program.

4.20. Elementet e programit janë të rregulluar në mënyrë hierarkike në tre nivele

- niveli i parë: sektorë dhe njësi të pavarura në Ministri dhe Shtatmadhorinë e Armatës.
- niveli i dytë: komanda në Armatë dhe Akademinë ushtarake.
- niveli i tretë: njësi të Armatës, në varësi të elementeve të programit të nivelit të parë dhe të dytë.

4.21. Kompetencat, të drejtat dhe përgjegjësitë në përcaktimin e nevojave dhe posedimin e mjeteve të miratuara, sipas sistemimit dhe formimit, jepen në Skemën për sigurinë financiare, shtojca nr.



4.27. Përmbajtja e udhëzimeve të nxjerra nga drejtuesit e programit është e përcaktuar në nenin 34 të Rregullores. Drejtuesit e programeve ndaj pjesës tjetër të pjesëmarrësve në procesin e programimit, veprojnë me kërkesa të qarta dhe specifike kurse baza është qasja alternative përkatësisht ofrimi i disa alternativave, me argumente dhe fakte.

Nga zgjidhjet alternative të ofruara, duke marrë parasysh anët pozitive dhe negative të secilës zgjidhje të propozuar, nëpërmjet përzgjedhjes pozitive zgjidhet alternativa më e mirë.

### **Planifikimi i takimeve për programet sipas fushave funksionale**

4.28. Çdo vit nga data 1 deri më 15 prill organizohen takime planifikuese sipas programeve për të shprehur dhe harmonizuar nevojat dhe për të arritur përdorimin sa më optimal të burimeve në dispozicion, për të siguruar realizimin e objektivave të DPR dhe mbështetjen më të mirë të mundshme për kryerje të suksesshme të misioneve të mbrojtjes. Këto takime duhet të mundësojnë shqyrtim të koordinuar të programeve për vitin buxhetor dhe 3 vitet e ardhshme programore.

Drejtuesit e programit janë përgjegjës për organizimin e takimeve me pjesëmarrësit e duhur për zhvillimin dhe zbatimin e një programi specifik.

Mbledhjet vjetore të planifikimit të programit kryhen për fushat e mëposhtme:

- Personel;
- Edukim dhe trajnim;
- Mbështetje logjistike;
- Pajisje dhe modernizim;
- Objekte dhe infrastruktura;
- Misione paqësore dhe humanitare;
- Fusha të tjera sipas nevojës.

4.29. Takimet vjetore të planifikimit janë veçanërisht të rëndësishme në shumë aspekte, në veçanti për shkak të::

- mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave përkatëse;
- perceptimin e dobësive në periudhën e kaluar;
- perceptimin dhe përcaktimin real të nevojave;
- përcaktimin e nënprogrameve, detyrave, aktiviteteve dhe projekteve;
- gjetjen e zgjidhjeve alternative;
- përgatitjen e planeve vjetore të qëndrueshme dhe të koordinuara;
- përgatitjen e buxhetit të propozuar për vitin e ardhshëm dhe projektimin e buxheteve për dy vitet e ardhshme;
- zgjidhjen e problemeve të evidentuara brenda fushës së programit.

4.30. Në punën e takimeve vjetore të planifikimit për programet, drejtuesi i programit përfshin të gjithë elementet e programit (sektorët, njësitë, komandat dhe repartet) që kanë kompetencë nga fushëveprimi i programit që ai drejton.

Për shembull: në mbledhjen vjetore të planifikimit për programin e stërvitjes së Armatës marrin pjesë personeli përgjegjës i asaj zone në J-7 të Shtatmadhorisë së Armatës, por edhe përgjegjësit për stërvitjen në komanda dhe njësi (KPO, komanda për stërvitje, komanda për mbështetje logjistike, brigadat, batalionet e pavarura, etj).

4.31. Në bazë të propozimeve, nën drejtimin e drejtuesit të programit, përpunohet versioni i parë i programit (propozimi i programit). Propozim-programi përmban të gjitha nevojat dhe kërkesat për burime personale, materiale dhe financiare, të grupuara sipas nënprogrameve, detyrave, aktiviteteve të projektit, elementeve të programit, prioriteteve dhe kategorive kryesore buxhetore, për katër vitet e ardhshme.

Në nenin 38 të Rregullores është përcaktuar procedura për analizën e propozimeve për detyra, aktivitete dhe projekte.

4.32. Pas analizave të kryera, drejtuesi i programit përgatit ilustrim tabelor të nevojave për burime financiare për të gjitha nënprogramet, detyrat, aktivitetet dhe projektet, me përmbajtjen, formën dhe listën e çështjeve jo të harmonizuara.



## **5. BUXHETIMI**

### **Sigurimi i mjeteve financiare**

5.1. Burimet financiare janë baza mbi të cilat varet drejtpërdrejt realizimi i planeve dhe programeve dhe sigurimi i tyre është detyrë parësore e personelit udhëheqës në Ministri dhe Armatë.

Burimi themelor i mjeteve të nevojshme financiare është buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut kurse krahas tij mund të parashihen mjetet e marra nga të hyrat personale dhe aktivitetet vetëfinancuese të Ministrisë së Mbrojtjes si dhe dhënia e dotacioneve dhe donacioneve të dedikuara, të cilat ofrohen nëpërmjet një procesi të organizuar të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

5.2. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut siguron financim afatgjatë dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes duke ndarë përqindje të caktuar të PBV-së së planifikuar në baza vjetore.

5.3. Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, në pajtim me rregulloret ligjore që e rregullojnë këtë fushë, përgatitet në vitin aktual dhe realizohet në vitin e ardhshëm. Ai zbatohet për periudhë prej një viti fiskal, i cili fillon më 1 janar kurse përfundon më 31 dhjetor.

Forma, mënyra dhe procedurat e zbatuara nga Ministria e Mbrojtjes në procesin buxhetor janë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Buxhetit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 64/2005).

### **Propozimbuxheti i MB-së**

5.4. Përgatitja e propozim-buxhetit është faza e tretë e RRPPBR-së, në të cilën, me aplikimin e modeleve dhe teknikave të pranuar për vlerësimin dhe parashikimin e shpenzimeve për programet e miratuara, përgatitet propozim buxheti për vitin e ardhshëm dhe dy vitet e ardhshme.

5.5. Në këtë fazë të RRPPBR-së sigurohen burime financiare për realizimin e qëllimeve, prioriteteve dhe detyrave të përcaktuara që rezultojnë nga dokumentet e miratuara në fazat e mëparshme.

### **Përgatitja e propozimbuxhetit**

5.6. Propozim - buxheti përgatitet në bazë të këtyre dokumenteve:

1. Qarkores buxhetore;
2. Udhëzimeve për përgatitjen e propozim-buxhetit;
3. Urdhrin i shefit të Shtatmadhorisë për përgatitjen e propozim-buxhetit në Armatës dhe
4. Dokumenteve të lëshuara nga pjesëmarrës të tjerë në RRPPBR.

Qarkorja buxhetore miratohet nga Ministria e Financave ndërsa dokumentet e tjera miratohen nga Ministria e Mbrojtjes.

5.7. Propozim-buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin e ardhshëm, sipas strukturës së përcaktuar programore dhe bartësve të aktiviteve, përgatitet në periudhën nga data 15 qershor deri më 15 gusht të këtij viti..

## **Qarkorja buxhetore**

5.8. Bazuar në Strategjinë e miratuar fiskale, Ministria e Financave, jo më vonë se data 15 qershor e këtij viti, bartësve të zonave funksionale (për funksionin "Veprimtaritë dhe shërbimet e mbrojtjes", Ministrisë së Mbrojtjes), u jep udhëzime në formularin e qarkores buxhetore, në bazë të së cilës shfrytëzuesit buxhetorë paraqesin kërkesë për propozim- buxhetin për vitin e ardhshëm.

5.9. Qarkorja buxhetore, ndër të tjera, përmban këto elemente:

- përcakton prioritetet strategjike të Qeverisë me propozim të programeve të Qeverisë, të cilat shfrytëzuesit buxhetorë janë të obliguar t'i mbështesin;
- shumat maksimale të mjeteve të miratuara për përdorues buxhetor
- udhëzime për përgatitjen e propozim-buxhetit
- kërkesat dhe
- informacione të tjera të nevojshme,

### **Udhëzime për përgatitjen e propozimbuxhetit**

5.10. Udhëzimet për përgatitjen e propozim-buxhetit për vitin e ardhshëm dhe projeksionin e buxhetit për dy vitet e ardhshme i jep ministri i Mbrojtjes.

Në bazë të udhëzimeve të ministrit, Sekretari i shtetit, si kryetar i grupit të programit, jep udhëzime dhe sqarime shtesë për drejtuesit e programeve dhe elementëve të programit kurse shefi i Shtatmadhorisë jep urdhër për përgatitjen e propozim-buxhetit për nevojat e programeve në kuadër të ARM-së.

5.11. Në udhëzimet për përgatitjen e propozimbuxhetit, ministri përcakton prioritetet, shpërndarjen sipas kategorive të shpenzimeve dhe çështje të tjera nga fusha e buxhetimit.

Sekretari i shtetit, nëpërmjet grupit të programit dhe drejtuesve të programit, jep udhëzime dhe sqarime shtesë për përgatitjen e propozim-buxhetit.

SF i përgatit udhëzimet dhe ofron mbështetje profesionale dhe teknike për grupin e programit.

5.12. Me qëllim të realizimit të strukturës së planifikuar programore si dhe saktësisimit të procedurave të caktuara, drejtuesit e programit japin udhëzime shtesë, me të cilat bartësve të detyrave, projekteve dhe elementeve programore, në kuadër të programit, u jepen rekomandime të posaçme.

### **Roli dhe përgjegjësitë e shefit të Shtatmadhorisë së ARM-së**

5.13. Sipas nenit 63 të Rregullores, shefi i Shtatmadhorisë së ARM-së është përgjegjës për përgatitjen e propozim-buxhetit për strukturën e krijuar programore në ARM. Për këtë, jep urdhër për përgatitjen e propozim-buxhetit në ARM, në të cilin:

4. Përcakton aktivitetet në ARM për vitin e ardhshëm (trajnime, ushtrime, pjesëmarrje në misione paqësore, ndryshime në strukturën formative, zhvillim të personelit etj.)
5. Përcakton prioritetet e ARM-së, sipas aktiviteteve dhe pajisjeve,
6. U jep udhëzime drejtuesve të programeve, për programet e ARM-së,
7. Përcakton përgjegjësitë dhe obligimet e komandantëve të elementeve të programit (komandave dhe njësisive), në fazën e buxhetimit,
8. Përcakton afatet për përpunimin dhe dorëzimin,
9. Përcakton datë për shqyrtimin dhe miratimin e propozim-buxhetit për ARM dhe
10. Rregullon çështje të tjera për përfundimin me sukses të kësaj veprimtarie.

5.14. G8 në Shtatmadhorinë e ARM-së, përgatit urdhrin dhe është përgjegjës edhe për përgatitjen e propozimbuxhetit në ARM.

## **Dokumente të lëshuara nga pjesëmarrës të tjerë në Sistemin e PPBR**

5.15. Mbi bazën e urdhrat të shefit të Shtatmadhorisë së ARM-së, shefat e seksioneve J në Shtatmadhorinë e ARM dhe komandantët që kanë përgjegjësi në zbatimin e disa prej detyrave në strukturën e vendosur të programit nga neni 33 të Rregullores, lëshojnë udhëzime dhe urdhra më të hollësishme që sqarojnë metodën, procedurat, afatet dhe udhëzimet e tjera të nevojshme për përgatitjen dhe paraqitjen e propozim-buxhetit për komandat udhëheqëse dhe G8 në Shtatmadhorinë e ARM-së.

### **Mënyra e shprehjes së nevojave në propozimbuxhetin**

5.16. Brenda afatit të përcaktuar në qarkoren buxhetore dhe udhëzimet e personave përkatës, personat përgjegjës paraqesin propozim- buxhetin për strukturat në kompetencën e tyre. Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve bëhet në formë tabelore dhe tekstuale të parapara me qarkoren buxhetore, e klasifikuar sipas natyrës së të hyrave dhe shpenzimeve, në pajtim me rregulloret për klasifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve.

5.17. Rregulloret për klasifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve përcaktohen nga Ministria e Financave dhe janë pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi, si shtojcë nr. -----

5.18. Për standardizimin, unifikimin dhe sigurimin e mbështetjes informatike për procedurën gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit në elementet e programit, si mjete ndihmëse, me këtë Udhëzues përcaktohen këto formularë:

1. Formulari i propozim- buxhetit B-1,
2. Formulari i propozim- buxhetit B-2,
3. Formulari i propozim-buxhetit B-3 dhe
4. Formularët për mbështetjen e normave të buxhetit (B-40 deri në B-48).

Formularët janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzuesi dhe jepen si shtojcë nr. -----

Me ndihmën e këtyre dokumenteve sigurohet zbatimi i plotë i parimeve nga RRPPBR dhe mundësohen detajet në paraqitjen e strukturës së shpenzimeve buxhetore.

5.19. Formularët e numrit rendor 4, pika 5.23. të këtij Udhëzuesi, janë në funksion të mbështetjes së normave të buxhetit, dalin nga rregulloret për klasifikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave dhe pas ndryshimeve të caktuara në to, formularët për mbështetjen e normave të buxhetit (B-40 deri në B-48) përditësohen.

5.20. Formularët e përcaktuar me këtë udhëzues janë në funksion të plotësimit të kushteve dhe kritereve për dokumentacion përkatës dhe transparencë të procesit buxhetor në Ministrinë e Mbrojtjes.

Me zbatimin e këtyre formularëve sigurohet:

- Vendosja e standardeve dhe procedurave në punë,
- Mbështetja e elementeve fiskale, të shprehura në qarkoren buxhetore,
- Transparenca e buxhetit,
- Krijimi i bazës së të dhënave për përpunim automatik,
- Analiza dhe përgatitja e raporteve,
- Saktësia në vlerësimin dhe përcaktimin e shpenzimeve,
- Cilësia në shpërndarjen e burimeve,
- Ndërtimi i arsytuar i normave të buxhetit,
- Shpërndarja e brendshme e burimeve,
- Përshtatja në kufizimet buxhetore,
- Matja e procesit buxhetor dhe
- Përfitime të tjera.

### **Shqyrtimi dhe miratimi i propozimbuxhetit**

5.21. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit bëhet në kuadër të strukturës së caktuar të kompetencave dhe obligimeve funksionale në RRPPBR, të përcaktuara në nenin 7 të Rregullores.

5.22. Për nevojat e RRPPBR në Ministrinë e Mbrojtjes, me këtë Udhëzues është paraparë shqyrtimi dhe miratimi i propozimbuxhetit në disa faza, përkatësisht:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit në nivel programi, në kompetencë të drejtuesve të programit.
2. Shqyrtimi dhe miratimi në Shtatmadhorisë së ARM-së, për strukturën programore të ARM-së, në kompetencë të shefit të Shtatmadhorisë së ARM-së.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i grupit të programit, për strukturën programore në Ministrinë e Mbrojtjes, në kompetencë të Sekretarit shtetëror dhe
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-buxhetit të grupit drejtues, nën kompetencë të ministrit.

5.23. Shqyrtimi i propozim-buxhetit në nivel programi bëhet me qëllim harmonizimin e nevojave financiare për realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve programore me mundësitë e përgjithshme që janë miratuar për programin konkret.

5.24. Shtatmadhuria e ARM-së është përgjegjëse për përgatitjen e propozim-buxhetit për strukturën e përcaktuara programore që ka të bëjë me ARM-në.

G8 i Shtatmadhorisë së ARM-së kryen punë profesionale, teknike dhe organizative në fazën e hartimit të propozim-buxhetit për programet që kanë të bëjnë me ARM-në.


5.25. Buxheti i propozuar i Ministrisë së Mbrojtjes, pas koordinimit të grupit programor, i dërgohet Ministrit dhe grupit të udhëheqjes për shqyrtim dhe miratim.

5.26 Propozim-buxheti i miratuar i Ministrisë së Mbrojtjes i dorëzohet Ministrisë së Financave, brenda afatit të përcaktuar me Ligjin e Buxhetit.

5.27. Ministri i Mbrojtjes mund të propozojë ndryshime në propozim-buxhetin e dorëzuar në Ministrinë e Financave deri në miratimin e tij në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

5.28. Aktivitetet dhe afatet në procesin buxhetor të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të shihen në këtë pasqyrë skematike:

Ilustrimi skematik i procesit buxhetor në RM



Skema nr. 6

## **6. REALIZIMI**

6.1. Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes realizohet në pajtim me dispozitat e Ligjit të Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili miratohet së bashku me miratimin e buxhetit si dhe aktet e brendshme nënligjore të Ministrisë së Mbrojtjes (rregullore, udhëzime, drejtime, vendime, etj.).

### **Plani financiar i MB-së**

6.2. Në bazë të Ligjit të Realizimit të Buxhetit, ministri i Mbrojtjes miraton Planin financiar (në tekstin e mëtejshëm: PF) brenda 25 ditëve nga miratimi i buxhetit, i cili rregullon kompetencat, përgjegjësitë dhe dinamikën e realizimit.

PF është plan vjetor për financimin e nevojave të përgjithshme, i cili mbështet realizimin e qëllimeve dhe prioritetëve të vendosura në bazë tremujore, sipas metodologjisë dhe dinamikës së realizimit të përcaktuar paraprakisht.

6.3. Mbështetur në PF vjetor, Ministria e Mbrojtjes përgatit plan financiar për çdo tremujor, sipas xhirollogarive, muajve, programeve, nënprogrameve dhe normave, duke marrë parasysh planin e shpërndarjes, i cili dorëzohet për çdo tremujor nga bartësi i programit. Plani financiar tremujor i paraqitet thesarit të Ministrisë së Financave jo më vonë se 5 ditë para fillimit të tremujorit, për miratim. Përmbajtja e PF është në pajtim me formën dhe përmbajtjen e përcaktuar nga Ministria e Financave dhe jepet si shtojcë nr. të këtij Udhëzuesi.

6.4. Ministri i Mbrojtjes shpërndan mjetet buxhetore të miratuara sipas bartësve të planifikimit, duke përgatitur PF në bazë të strukturës programore të miratuar.

6.5. Ministria e Mbrojtjes në RRPRBR për nevojat e veta përdor edhe formularë shtesë për monitorimin e realizimit të buxhetit. Qëllimi kryesor i formularëve shtesë është të ofrojë informacione shtesë mbi realizimin dhe pasqyrën e zbatimit nga bartësit e programit, detyrat dhe normat e shpenzimeve.

Formularët shtesë jepen si shtojcë nr. ----- të këtij Udhëzuesi.

### **Rishikimi dhe shpërndarja (ridestini)**

6.6. Gjatë vitit mund të ketë ndryshime dhe shtesa në mjetet e miratuara në buxhet përkatësisht rishikimin e buxhetit. Si bazë për rishikimin e buxhetit është shmangia nga projeksioni i planifikuar i të hyrave dhe shpenzimeve, pas 5 muajve të parë të vitit.

Si arsye për rishikim mund të përmenden:

- rritja e arkëtimit të të hyrave, që nënkupton edhe rritje të shpenzimeve buxhetore,
- përqindje e ulët e realizimit të buxhetit të miratuar,
- mosrealizimi i të hyrave të planifikuara mbi 5% dhe
- situata të tjera emergjente që mund të krijohen në vend

6.7. Gjatë vitit mund të shfaqen faktorë që ndikojnë në paraqitjen e shpenzimeve të reja, që rezulton me nevojën e rishpërndarjes (ridestinit) të mjeteve të miratuara me buxhet.

Bazat për rishpërndarjen brenda shumës maksimale të miratuar nga buxheti janë: shmangie të konsiderueshme nga aktivitetet e planifikuara, prezantimi i aktivitetëve apo projekteve të reja (të paplanifikuara), ndryshimi i prioritetëve, por edhe gabimet në përgatitjen e propozim-buxhetit.

6.8. Rishpërndarja e mjeteve është e mundur brenda një llogarie, ndërmjet programeve, nënprogrameve dhe normave.

Në vitin aktual, maksimumi 15% e shumës së përgjithshme të mjeteve të miratuara mund të ridestinohet brenda një programi.

Duhet të ketë këmbëngulje që rishpërndarjet (ridestinimet) të bëhen sa më të rralla dhe në sasi sa më të vogla. Nëse janë të shpeshta dhe me sasi më të madhe, është e nevojshme të bëhet analizë e gjithë procesit, për të përcaktuar arsyet e shmangieve.

### Plani i prokurimeve

6.9. Buxheti zbatohet në pajtim me Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP), Udhëzimin për akuizicion në Ministrinë e Mbrojtjes, planet vjetore të punës, planin e trajnimit dhe aktet tjera që i rregullojnë nevojat dhe këtë çështje.

Ministri i Mbrojtjes, bazuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe procedurat e përcaktuara në Udhëzuesin për akuizicion, miraton plan vjetor të prokurimeve publike, në pajtim me kërkesat e miratuara të programit. Në zbatimin e procedurave të prokurimeve publike në Ministrinë e Mbrojtjes duhet të respektohen parimet e transparencës, përgjegjësisë, ligjshmërisë, ekonomisë dhe efikasitetit në punë.

6.10. Për realizimin e prokurimeve në Ministrinë e Mbrojtjes bëhen këto planet :

- Plani për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve që janë objekt i prokurimeve publike.
- Plani për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe gjërave që janë të natyrës mbrojtëse dhe të sigurisë për vendin dhe
- Plani për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe sendeve me vlerë të ulët.

6.11. Planet e prokurimit paraqesin nevoja të përcaktuara sipas Udhëzuesit për akuizicion dhe nevoja të tjera operative në Ministrinë e Mbrojtjes.

6.12. Plani për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve që janë objekt i prokurimit publik i referohet mallrave, shërbimeve dhe punëve që janë të natyrës publike dhe si të tilla prokurohen në pajtim me dispozitat e Ligjit të Prokurimeve Publike, duke zbatuar procedurat e prokurimit publik.

Ky plan miratohet nga ministri i Mbrojtjes në fund të muajit janar dhe brenda 5 ditëve nga miratimi i dorëzohet Byrosë së Prokurimeve Publike, pranë Ministrisë së Financave.


6.13. Plani për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve që janë të natyrës mbrojtëse dhe sigurisë për vendin (neni 3 i LPP) dhe i referohen prokurimit të pajisjeve të caktuara me vendim të Qeverisë, përpunohet në fund të janar dhe dorëzohet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

6.14. Për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe sendeve me vlerë të ulët (deri në shumën e përcaktuar në nenet 72 dhe 73 të Ligjit të Prokurimeve Publike), përgatitet plan i veçantë.

Ky plan realizohet nëpërmjet elementeve programore, në pajtim me Rregulloren për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe sendeve me vlerë të ulët, që mundëson decentralizimin e burimeve financiare, në fazën e realizimit.

6.15. Fillimi i prokurimeve të planifikuara nga pikat 114 dhe 115 të këtij Udhëzuesi, sipas dinamikës së parashikuar të zbatimit, kryhet nga bartësi kompetent i mjetit, shërbimit ose punimeve kurse procedurën (zbatimin) e udhëheq Njësia e Prokurimeve në Sektorin e logjistikës në MM-së.

6.16. Aktivitetet në lidhje me përgatitjen e PF dhe Planit të prokurimeve publike si dhe aktivitete të tjera, jepen në pamjen skematike të mëposhtme:



## Skema nr. 7

6.17. Forma dhe përmbajtja e planeve të prokurimeve jepen si bashkëngjitje nr. ----- në këtë udhëzues

Ministria e Mbrojtjes në zbatimin e SPPBR-së, për përdorim të brendshëm, me qëllim paraqitjen më të hollësishme të prokurimeve të planifikuara të mjeteve dhe pajisjeve, përdor formulare shtesë.

6.18. Për monitorimin e realizimit të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, SF përgatit dhe dorëzon raporte për realizim deri tek elementet e programit dhe menaxherët e programit.

Forma dhe përmbajtja e raporteve është në pajtim me zgjidhjet aplikative të softuerit të kontabilitetit financiar në SF.

Këto raporte paraqesin bazën për inicimin e ridestinimit e nevojshëm të burimeve financiare gjatë vitit buxhetor, brenda programit ose nga një program në tjetrin.

6.19. Bazuar në raportet nga pika e mëparshme, elementet e programit përgjegjës për programet, përgatisin raportet e tyre (të brendshme) për realizimin e planit financiar, detyrat dhe projektet e planifikuara në kuadër të programit.

Raportet përgatiten të paktën dy herë në vit (në pajtim me nenin 73 të Rregullores së PPBR), në nivel të të mujor, jo më vonë se fundi i shtatorit dhe nivel vjetor, jo më vonë se 15 shkurti i vitit aktual për vitin e kaluar.

## 7. SHQYRTIMI I AFTËSIVE MBROJTJESE

7.1. Shqyrtimi i aftësive mbrojtëse është dokument që paraqet nivelin e arritur të aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse në dy vitet e fundit si dhe ndikimin e programeve në arritjen e qëllimeve të planifikimit. **POS** miratohet çdo dy vjet në janar dhe i paraprin **SPR-së**.

6.21. Roli dhe qëllimi i shqyrtimit të aftësive mbrojtëse gjenden në nenet 23 deri në 26 të Rregullores.

Me përgatitjen e shqyrtimit të aftësive mbrojtëse, Ministria e Mbrojtjes përmbush obligimin ligjor dhe i realizon synimet e mëposhtme:

1. Njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për gjendjen në mbrojtje dhe Armatë;
2. Njofton Komisionin e sigurisë dhe mbrojtjes në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për gjendjen në mbrojtje dhe në Armatë;
3. Njofton presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komandantin suprem të Armatës për gjendjen në mbrojtje dhe në Armatë;
4. Propozon dhe fillon procedurë për ndryshimin e mundshëm të dokumenteve strategjike që paraqesin bazën e planifikimit të mbrojtjes, nga neni 4 i Rregullores;
5. Me dorëzimin e POS në Qeveri, Parlament dhe te presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, maksimalisht rritet transparencën në planifikimin e mbrojtjes dhe realizimin e qëllimeve të planifikimit;
6. Deri te organet më të larta shtetërore (Kuvend, Qeveri dhe Kryetar) dorëzohet Raporti për realizimin e buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe rezultatet e arritura.

6.22. Sekretari i shtetit përpunimin e shqyrtimit të aftësive mbrojtëse e realizon nëpërmjet këshilltarëve shtetëror dhe udhëheqëse të sektorëve, për Ministrinë dhe shefin e Shtatmadhorisë, për pjesën që e përgatit Armata.

Pjesët e **POS** të zhvilluara sipas fushave nga neni 25 i Rregullores, të përpunuara në pikat 6.23 deri në ..... të këtij Udhëzuesi, janë bashkuar në një dokument të vetëm nga Sektori i politikës dhe planifikimit.

#### 6.23. Politika mbrojtëse dhe planet- Sektori i politikës dhe planifikimit.

Në sferën e sigurisë është dhënë pasqyrë e mjedisit të sigurisë, interesave dhe qëllimeve të Republikës së Maqedonisë së Veriut si dhe vlerësim i kërcënimeve dhe rreziqeve.

Në fushën e politikës dhe planifikimit të mbrojtjes, jepet pasqyrë e këtyre çështjeve: planifikimi strategjik, plani i mbrojtjes, përgatitjet për mbrojtje dhe bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes përmes një pasqyre të realizimit të:

- politikave dhe strategjisë së mbrojtjes
- programit për vazhdimin e reformave;
- programit të partneritetit për paqe;
- bashkëpunimit dhe marrëveshjeve shumëpalëshe;
- marrëveshjeve me NATO-n
- nismave dhe bashkëpunimit rajonal;
- bashkëpunimit dypalësh;
- kontrollit të armëve;
- çështjeve të tjera në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar të Ministrisë së Mbrojtjes dhe forcave të armatosura.

#### 6.24. Qëllimet afatmesme që duhet të arrihen - Sektori i politikave dhe planifikimit

Në këtë fushë është paraqitur niveli i realizimit dhe arritjes së qëllimeve afatmesme sipas fushave funksionale në periudhën raportuese.

#### 6.25. Politika dhe menaxhimi i personelit– Sektori i burimeve njerëzore për Ministrinë kurse Shtatmadhoria për Armatën

- Kjo fushë ofron përmbledhje të çështjeve të mëposhtme:
- Ndryshime në rregulloren ligjore normative lidhur me menaxhimin e personelit
- Ndryshimet në personelin e MM-së dhe ARM-së
- rekrutim dhe pranim të personelit për nevojat e ministrive dhe të Armatës;
- arsimim dhe trajnim (kurse, trajnime gjuhësore, trajnime profesionale, arsimim të mëtejshëm, bursa studentore;
- menaxhimi i përbërjes rezervë dhe ushtarëve në shërbim vullnetar
- ushtarak.
- zhvillimi i karrierës;
- mbajtja dhe motivimi i personelit dhe planifikimi i largimit të personelit;
- përmirësimi i standardit të punonjësve (standardi i jetesës, ndihma sociale, privilegjet dhe përfitimet, kushtet e punës dhe mbrojtja e të drejtave të punonjësve dhe familjeve të tyre, sigurimi i banimit);
- dalja në pension dhe pensionimi para kohës për shkak të ndryshimeve strukturore;

#### 6.25. **Logjistika** – Sektori i logjistikës i Ministrisë kurse Shtatmadhoria për Armatën

Kjo fushë jep shqyrtim të gjendjes në logjistikë sipas:

- ndryshimeve në konceptin nacional për mbështetje logjistike
- kategorive të furnizimit.
- aftësive/kapaciteteve nacionale për vendosje dhe mirëmbajtje
- gatishmërisë logjistike dhe qëndrueshmërisë,
- aranzhimeve dhe trajnimeve në logjistikë
- aftësive/kapaciteteve për mbështetje si vend pritës.

#### 6.26. **Struktura e forcave dhe shkalla e zhvillimit të aftësive dhe kapaciteteve** Shtatmadhoria e Armatës.

Kjo fushë jep shqyrtim për:

- udhëheqje dhe komandë,
- gatishmëri personale,

- trajnime (të njësisve dhe individuale)
- gatishmëri për mobilizim,
- sigurim logjistik,
- gjendjen e pajisjeve luftarake,
- pajisjen dhe modernizimin,
- moralin,
- ngjarje të jashtëzakonshme dhe
- të tjera.

6.27. **Pjesëmarrje në operacione dhe misione** – Sektori i politikës dhe planifikimit  
Kjo fushë jep shqyrtim të gjendjes me pjesëmarrje në operacione dhe misione.

6.28. **Pjesëmarrje në formacioneve multinacionale dhe aftësi** - Sektori i politikës dhe planifikimit  
Kjo fushë jep shqyrtim të gjendjes me pjesëmarrje në formacione multinacionale dhe aftësi, përkatësisht: me cilët vende, qëllimi, lloji, madhësia, misioni, gatishmëria luftarake, trajnimi, ushtrimet dhe niveli i vlerësimit.

6.29. **Trajnimi dhe aktivitetet e ushtrimeve**- Shtatmadhuria e Armatës  
Kjo fushë jep pasqyrë të gjendjes së trajnimit (të njësisve dhe individuale) dhe aktiviteteve të ushtrimit.

6.30. **Objekte dhe infrastrukturë** – Sektori i patundshmërive  
Kjo fushë jep pasqyrë të gjendjes së infrastrukturës dhe objekteve në Ministri dhe Armatë përkatësisht menaxhimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e patundshmërive.

**6.27. Financat** – Sektori i financave dhe menaxhimit të burimeve. Në këtë pjesë të **POS**, dorëzohet raport për:

- realizimin e buxhetit sipas programeve dhe kategorive të shpenzimeve;
- realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- rishikimin dhe ridestinimin;
- kryerjen e revizioneve të brendshme dhe të jashtme;
- çështje të tjera në fushën e financimit.

6.28. **Rekomandim për tejkalimin e dobësive të konstatuara** – Sektori i politikës dhe planifikimit  
Në bazë të raporteve sipas fushave, pikëpamjet dhe propozimet përmbyllëse, SPP përgatit konkluzion të përgjithshëm dhe rekomandime për tejkalimin e dobësive të identifikuara si pjesë përbërëse e **POS**.

- 6.29. Rishikimi i kapaciteteve të mbrojtjes paraqet dokument kyç në nxitjen e ndryshimeve dhe bazë për:
1. Inicimin dhe propozimin e ndryshimeve në dokumentet strategjike, varësisht nëse ato janë në kompetencë të Kuvendit, Qeverisë apo presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
  2. Dhënien e udhëzimeve, të parashikuara në nenin 26 të Rregullores, përkatësisht përditësimi i planit afatgjatë dhe afatmesëm për zhvillimin dhe programimin, zbatimin e programeve në vitin e ardhshëm dhe përgatitjen e propozim-buxhetit.

## **8. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

8.1. Në rast të ndryshimeve organizative dhe formacionit në Ministri dhe Armatë, pasardhësi ligjor i njësisë organizative të ndryshuar ose të shfuqizuar merr përsipër obligimet e këtij Udhëzuesi.

7.2. Shtojcat dhe formularët, të paraqitur në përmbajtjen e tij, janë pjesë përbërëse e këtij Udhëzuesi. Njëtrajtshmëria e dokumenteve sigurohet nëpërmjet shtojcave dhe formularëve. Autorizohet udhëheqësi SF, sipas nevojës, të bëjë ndryshime dhe shtesa në pjesën e shtojcave dhe formularëve, me përjashtim të Rregulloreve për klasifikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave.

7.3. Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzuesi, shfuqizohet Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores për planifikim, programim, buxhetim dhe realizim në Ministrinë e Mbrojtjes nr. 01-612/1 më 23.01.2007, nr. 01-2907/1 më 14.4.2008 dhe nr. 01-5062/1 më 14.7.2010. Ky udhëzues hyn në fuqi ditën e miratimit.

**MINISTRJA E MBROJTJES**  
**Radmilla Sheqerinska Jankovska**